

SONY®

4-478-729-41(2) (AL)

Kamerë dixhitale me
objektiv të ndërrueshëm

α **α**
7 **7R**

Udhëzues

E-mount

ILCE-7/ILCE-7R

Shqip

E-mount

Regjistri i zotëruesit

Modeli dhe numrat serialë ndodhen në pjesën e poshtme. Regjistroni numrin serial në hapësirën e dhënë më poshtë. Referojuni këtyre numrave sa herë që kontaktoni me shitësin tuaj Sony në lidhje me këtë produkt.

Modeli nr. WW328261 (ILCE-7R)/
WW328262 (ILCE-7)

Nr. i serisë _____

Modeli nr. AC-UB10C/AC-UB10D

Nr. i serisë _____

ILCE-7R Modeli nr. WW328261

ILCE-7 Modeli nr. WW328262

PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun zjarrit ose të goditjeve elektrike, njësia nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

UDHËZIME TË RËNDËSISHME MBI SIGURINË - RUAJINI KËTO UDHËZIME RREZIK PËR TË ZVOGËLUAR RREZIKUN E ZJARRIT OSE TË GODITJEVE ELEKTRIKE, NDIQNI ME KUJDES KËTO UDHËZIME

Nëse forma e spinës nuk përputhet me formën e prizës, përdorni përshtatës spine me konfigurimin e duhur për prizën.

AL

2

KUJDES

Paketa e baterisë

Nëse keqpërdoret, paketa e baterisë mund të shpërthejë duke shkaktuar zjarr ose edhe djegie kimike. Zbatoni masat e mëposhtme paraprake.

- Mos e çmontoni.
- Mos e shtypni dhe mos e ekspozoni paketën e baterisë ndaj ndonjë goditjeje apo force si goditje me çekiç, rënie apo shkelje të saj.
- Mos shkaktoni qark të shkurtër dhe mos lejoni që objektet metalike të bien në kontakt me polet e baterisë.
- Mos e ekspozoni ndaj temperaturave të larta mbi 60°C (140°F) si p.sh. në dritë të drejtpërdrejtë dielli apo në një makinë të parkuar në diell.
- Mos e digjini ose mos e ekspozoni në zjarr.
- Mos përdorni bateri me jone litiumi, të dëmtuara apo që rrjedhin.
- Sigurohuni që të ngarkoni paketën e baterisë duke përdorur një ngarkues original Sony ose një pajisje që mund të ngarkojë paketën e baterisë.
- Mbajeni paketën e baterisë larg nga fëmijët e vegjël.
- Mbajeni të thatë paketën e baterisë.
- Zëvendësojeni vetëm me të njëjtin lloj ose me një lloj ekuivalent të rekomanduar nga Sony.
- Hidhni paketat e përdorura të baterive siç përshkruhet në udhëzime.

Ushqyesi

Përdorni prizën më të afërt të murit kur përdorni ushqyesin. Shkëputeni menjëherë ushqyesin nga priza e murit nëse ndodh ndonjë keqfunksionim gjatë përdorimit të aparatit.

Kordoni elektrik, nëse jepet, është disenjuar për përdorim konkret vetëm me këtë kamerë dhe nuk duhet të përdoret me pajisje të tjera elektrike.

Për klientët në Evropë

Shënim për klientët në vendet ku vlejnë direktivat e BE-së

Prodhuesi: Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japan.
Për pajtueshmërinë e produktit me BE-në: Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Germany



Përmes kësaj, Sony Corporation, deklaron se kjo kamerë dixhitale me objektiv të ndërrueshëm WW328261/WW328262 është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të direktivës 1999/5/KE. Për hollësi, vizitoni adresën e mëposhtme:

<http://www.compliance.sony.de/>

Shënim

Nëse elektriciteti apo elektromagnetizmi statik shkakton ndërprerjen (dështimin) e transferimit të të dhënave, rihapni aplikacionin ose shkëputni dhe lidhni kabllon e komunikimit (USB etj.).

Ky produkt është testuar dhe rezulton në pajtim me kufijtë e përcaktuar në rregulloren për pajisjet elektromagnetike për përdorimin e kabllave lidhëse nën 3 metra (9,8 këmbë).

Fushat elektromagnetike në frekuencat specifike mund të ndikojnë në figurën dhe zërin e kësaj njësie.

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (vlen në Bashkimin Evropian dhe në shtetet e tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)



Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se produkti nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, duhet të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për

riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Hedhja e baterive të përdorura (vlen në Bashkimin Evropian dhe në shtetet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)



Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që vjen me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat, për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash, kërkojnë lidhje të qëndrueshme me bateri të integruar, bateria duhet të zëvendësohet vetëm nga personeli i kualifikuar i shërbimit. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti.

Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.


Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Për klientët që e kanë blerë kamerën në dyqane të Japonisë që u drejtohen turistëve

Shënim

Disa shenja certifikimi për standardet e mbështetura nga kamera mund të konfirmohen në ekranin e kamerës.

Zgjidhni MENU →

 (Konfigurimi) 6 →

[Certification Logo].

Nëse nuk mund të shfaqen për shkak avarie me kamerën, kontaktoni me shitësin tuaj Sony ose pikën lokale të autorizuar të shërbimit Sony.

Për hollësi me funksionet Wi-Fi, shihni fletëpalosjen „Udhëzuesi i lidhjes Wi-Fi/One-touch (NFC)“.

Ky udhëzues mbulon disa modele.

Modeli i disponueshëm varet nga shtetet/rajonet.

Emri i modelit	Objektivi
ILCE-7	Nuk jepet
ILCE-7K	Jepet
ILCE-7R	Nuk jepet

Shënime mbi përdorimin e kamerës

Gjuha e ekranit

Mund të zgjidhni gjuhën e shfaqur në ekran me anë të menysë.

Procedura e shkrepjes

Kjo kamerë ka 2 modalitete për monitorimin e subjekteve: modaliteti i ekranit LCD që përdor ekranin LCD dhe modaliteti i pamjekërkuetit që përdor pamjekërkuetin.

Funksionet e integruara në kamerë

- Ky manual përshkruan pajisjet që mbështesin 1080 60i dhe 1080 50i. Për të kontrolluar nëse kamera mbështet 1080 60i ose 1080 50i, kontrolloni për shenjat e mëposhtme në fund të kamerës. Mbështet 1080 60i: 60i Mbështet 1080 50i: 50i
- Kjo kamerë mbështet filma në format 1080 60p ose 50p. Ndryshe nga modalitetet standarde të regjistrimit deri më sot, të cilat regjistrojnë në mënyrë Interlace, kjo kamerë regjistron në mënyrë Progressive. Kjo rrit rezolucionin dhe ofron një figurë më të shtruar dhe më pranë realitetit.

Krijimi i një skedari-databazë fotografish

Nëse futni kartë memorieje që nuk përmban skedar-databazë fotografish në kamerë dhe e ndizni këtë të fundit, kamera do të krijojë automatikisht skedarin-databazë të fotografive duke përdorur një pjesë të kapacitetit të kartës së memories. Procesi mund të marrë ca kohë dhe nuk do të mund ta përdorni kamerën derisa të përfundojë. Nëse ndodh ndonjë gabim i skedarit-databazë të fotografive, eksportoni të gjitha fotot në kompjuter me anë të „PlayMemories Home“ dhe pastaj formatoni kartën e memories nga kamera.

Shkrejpa me madhësi APS-C që mbështet objektiv me E-mount

Kjo kamerë vjen me sensor CMOS kuadri të plotë, 35 mm. Por madhësia e figurës caktohet automatikisht sipas cilësimit të madhësisë APS-C dhe madhësia e figurës është më e vogël kur përdoret madhësi APS-C që mbështet objektiv me E-mount (cilësimet fillestare).

Nuk ka kompensim për materiale të dëmtuara apo për probleme regjistrimi

Sony nuk kompenson për problemet në regjistrim apo dëmtimin e materialeve të regjistruara për shkak defekti me kamerën apo mjetin e regjistrimit etj.

Këshillimi për rezervim

Për të shmangur humbjen e të dhënave, kopjojini (rezervojini) gjithmonë të dhënat në njësi të tjera.

Shënime rreth ekranit LCD, pamjekërkuetit elektronik, objektivit dhe sensorit të figurës

- Ekranit LCD dhe pamjekërkuetit elektronik prodhohen me teknologji të përpikërisë tejet të lartë, në mënyrë që mbi 99,99% e pikëzave të jenë operative për përdorim efikas. Por, mund të qëllojnë pika të vogla të zeza dhe/ose të shndritshme (të bardha, të kuqe, të kaltra ose të gjelbra në ngjyrë) që shfaqen në mënyrë të vazhdueshme në ekranin LCD dhe në pamjekërkuetin elektronik. Këto pika janë normale gjatë procesit të prodhimit dhe nuk ndikojnë në asnjë mënyrë mbi figurën.
- Mos e mbani kamerën nga ekranin LCD.
- Kur përdorni objektiv të zmadhimit të lartë, bëni kujdes të mos i tërhiqni gishtat apo sende të tjera që mund të kenë ngecur në objektiv.

- Mos e ekspozoni kamerën ndaj dritës së diellit as mos shkrepi në drejtim të diellit për kohë të gjata. Mekanizmi i brendshëm mund të dëmtohet. Nëse drita fokusohet mbi një objekt aty pranë, mund të shkaktojë dhe zjarr.
- Fotot mund të lënë gjurmë lëvizjeje nëpër ekran në ambiente të ftohta. Kjo nuk tregon defekt.
Kur e ndizni kamerën në ambient të ftohtë, ekranin mund të errësohet për pak çaste. Kur kamera nxehet, ekranin do të funksionojë si normalisht.
- Figura e regjistruar mund të jetë ndryshe nga figura e vrojtuar përpara regjistrimit.

Shënime për regjistrimin për kohë të gjata

- Në varësi të kamerës dhe të temperaturës së baterisë, mund të mos filmoni dot ose energjia mund të fiket automatikisht për të mbrojtur kamerën.
Do të shfaqet një mesazh në ekran përpara se të fiket energjia apo përpara se të mos keni më mundësi filmimi.
Në raste të tilla, lëreni pajisjen fikur dhe prisni derisa të bjerë temperatura e kamerës dhe e baterisë. Nëse e ndizni pajisjen pa i lënë kamerën dhe baterinë të ftohen sa duhet, energjia mund të fiket vetë sërish ose mund të mos keni mundësi filmimi.
- Nën temperatura të larta ambienti, temperatura e kamerës rritet me shpejtësi.
- Kur rritet temperatura e kamerës, cilësia e figurës mund të përkeqësohet. Këshillohet që të prisni derisa temperatura e kamerës të bjerë përpara se të vijoni me shkrepijen.
- Sipërfaqja e kamerës mund të ngrohet. Kjo nuk tregon defekt.

Shënime mbi importimin e filmave AVCHD në kompjuter

Gjatë importimit të filmave AVCHD në kompjuter, shkarkoni dhe përdorni softuerin „PlayMemories Home“ nga faqja e mëposhtme:
<http://www.sony.net/pm/>

Shënime mbi luajtjen e filmave në pajisje të tjera

- Kjo kamerë përdor MPEG-4 AVC/H.264 High Profile për regjistrim në format AVCHD. Filmat e regjistruar në format AVCHD me këtë kamerë nuk mund të luhen në pajisjet e mëposhtme.
 - Pajisjet e tjera që mbështesin formatin AVCHD që nuk mbështesin High Profile
 - Pajisjet që nuk mbështesin formatin AVCHD
 Kjo kamerë përdor gjithashtu MPEG-4 AVC/H.264 Main Profile për regjistrim në format MP4. Për këtë arsye, filmat e regjistruar në format MP4 me këtë kamerë nuk mund të luhen në pajisje të ndryshme nga ato që mbështesin MPEG-4 AVC/H.264.
- Disqet e regjistruara me cilësi figure HD (rezolucion i lartë) mund të luhen vetëm në pajisje që mbështesin formatin AVCHD. Luajtësit ose regjistruerit me bazë DVD-je nuk mund të luajnë disqe me cilësi figure HD, pasi nuk mbështesin formatin AVCHD. Gjithashtu, luajtësit ose regjistruerit me bazë DVD-je mund të mos i nxjerrin dot nga njësi disqet e cilësisë së figurës HD.
- Filmimet e regjistruara në format 1080 60p/1080 50p mund të luhen vetëm në pajisje që mbështesin 1080 60p/1080 50p.

Paralajmërim mbi të drejtat e autorit

Emisionet televizive, filmat, videokasetat dhe materialet e tjera mund të jenë me të drejta autori. Regjistrimi i paautorizuar i këtyre materialeve mund të bjerë ndesh me dispozitat e ligjeve për të drejtat e autorit.

Ilustrimet e përdorura në këtë udhëzues

Fotografitë e përdorura si shembuj ilustrues në këtë udhëzues janë pamje të riprodhuara dhe jo foto konkrete të shkrepura nga kjo kamerë.

Mbi specifikimet e të dhënave të përshkruara në këtë udhëzues

Të dhënat mbi performancën dhe specifikimet përkufizohen sipas kushteve të mëposhtme, përveç kur përshkruhen ndryshe në udhëzues: në temperatura normale ambienti prej 25°C (77°F) dhe duke përdorur paketë baterie të ngarkuar plotësisht derisa llamba e ngarkimit të jetë fikur.


Shënime mbi shkrepjen me pamjekërkues


Kjo kamerë vjen me pamjekërkues ndriçimi organik elektrik, rezolucioni të lartë dhe kontrasti të lartë. Ky pamjekërkues arrin kënd të gjerë shikimi dhe çlodhje të gjatë të syve. Kjo kamerë është disenuar për të ofruar pamjekërkues me shikim të lehtë, duke balancuar siç duhet elementet e ndryshme.

- Figura mund të deformohet lehtë pranë këndeve të pamjekërkuesit. Kjo nuk tregon defekt. Kur ju duhet të kontrolloni çdo hollësi të përmbajtjes, mund përdorni dhe ekranin LCD.

Si të fikni përkohësisht funksionet e rrjetit me valë (Wi-Fi dhe NFC etj.)

Kur hipni në avion etj. mund t'i fikni përkohësisht të gjitha funksionet e rrjetit me valë.

Zgjidhni MENU →  [Wireless] → [Airplane Mode] → [On].

Nëse e caktoni [Airplane Mode] në [On], do të shfaqet një shenjë  (avioni) në ekran.


Shënime mbi rrjetin me valë

Nëse e humbisni apo ju grabisin kamerën, Sony nuk mban përgjegjësi për humbjen apo dëmin e shkaktuar nga hyrja apo përdorimi i paligjshëm i pikëhyrjes së regjistruar në kamerë.

Kontrollimi i artikujve të dhënë

Numri në kllapa tregon numrin e pjesëve.

- Kamera (1)
- Ushqyesi AC-UB10C/UB10D (1)
- Kapaku i trupit (1) (montuar në kamerë)




- Kordoni elektrik (1)* (nuk jepet në SHBA dhe në Kanada)



- Kapaku i kapëses MIS (1) (montuar në kamerë)
- Kupa e okularit (1) (montuar në kamerë)
- Udhëzues (1) (ky udhëzues)

* Me kamerën mund të jepen disa kordonë elektrikë. Përdorni atë që i përshtatet shtetit/rajonit ku ndodheni.


- Paketa e baterive të ringarkueshme NP-FW50 (1)




ILCE-7K:

- Objektivi FE 28-70 mm F3.5-5.6 OSS (1)/Kapaku i përpasmë i objektivit (1)/Kapaku i pasmë i objektivit (1)/Mbrojtësja e objektivit (1)

- Kablloja Micro USB (1)



- Rripi i supit (1)




Për mënyrën e lidhjes së rripit të supit në kamerë, drejtojeni faqes 13.


Identifikimi i pjesëve

Shihni faqet në kllapa për hollësi mbi funksionet e pjesëve.

Pjesa e përparme



Kur hiqet objektivi



- 1 Drita ndihmëse e fokusimit automatik/Llamba me fikje automatike
- 2 Graduesi i përparmë
- 3 Sensori i telekomandës
- 4 Butoni i shkëputjes së objektivit



- 5 Mikrofoli i integruar*¹
- 6 Piketat e montimit
- 7 Sensori i figurës*²
- 8 Unaza e montimit
- 9 Kontaktet*²

*1 Mos e mbuloni këtë pjesë gjatë filmimit.



Përndryshe mund të shkaktoni zhurmë ose të dobësoni volumnin.

*2 Mos i prekni drejtpërdrejt këto pjesë.





Pjesa e pasme




- 1 Kupa e okularit
- 2 Pamjekërkuesi
- 3 Butoni MENU (23)
- 4 Sensorët e okularit
- 5 Ekran LCD
 - Ekranin LCD mund ta rregulloni me lehtësi për kënd me shikim të lehtë dhe ta shkrepni nga çfarëdo pozicioni.
- 6 Graduesi i dioptrisë
 - Përshtateni graduesin e dioptrisë sipas shikimit tuaj derisa ekranin të shfaqet qartë në pamjekërkues.






- 7 Për shkrepje: Butoni C2 (i personalizuar 2)
Për shikim: Butoni \oplus (i zmadhimit)
- 8 Leva e ndërrimit midis AF/MF/AEL
- 9 Graduesi i pasmë

- 10 Për shkrepje: Butoni AF/MF
(fokusim automatik/fokusim
manual)/Butoni AEL
Për shikim: Butoni 
(treguesi i figurës)
- 11 Butoni MOVIE (39)
- 12 Për shkrepje: Butoni Fn (22)
Për shikim: Butoni 
(Dërgo në celular)
- 13 Rrotulla e komandimit
- 14 Për shkrepje: Butoni C3
(i personalizuar 3)
Për shikim: Butoni 
(fshirje) (41)
- 15 Llamba e hapjes
- 16 Butoni  (luajtje)

Ana e sipërme/Pamja anësore




- 1** Altoparlanti
- 2**  Shenja e pozicionit të sensorit të figurës
- 3** Foleja  (e mikrofonit)
- Kur lidhet një mikrofon i jashtëm, mikrofonin ndizet automatikisht. Nëse mikrofonin i jashtëm është i llojit me korrent nga fisha, korrentin merret nga kamera.
- 4** Foleja  (e kufjeve)
- 5** Llamba e ngarkimit
- 6** Multiterminali
- Mbështet pajisje me Micro USB.
- 7** Mikrofoleja HDMI
- 8** MIS*
- Disa prej aksesorëve mund të mos futen deri në fund dhe mund të rrinë disi të dala mbrapa MIS. Por, kur aksesorin uthitet me pjesën e përparme të kapëses, lidhja konsiderohet e kryer.
- 9** Graduesi i modaliteteve (42)
- 10** Çelësi i ndezjes/Butoni i diafragmës
- 11** Butoni C1 (i personalizuar 1)

12 Graduesi i kompensimit të ekspozimit


13 Kapëset për rripin e supit

- Lidhni të dy skajet e rripit te kamera.



14 **N** (Shenja N)

- Kjo shenjë tregon pikën e prekjes për lidhjen e kamerës me celularë që mbështesin NFC. Për hollësi rreth vendndodhjes së shenjes N në celularin tuaj, drejtojuni udhëzimeve të përdorimit të celularit.



- NFC (Near Field Communication; komunikimi sipas fushave të përiferëta) është një teknologji standarde ndërkombëtare komunikimi me valë me rreze të shkurtër.

15 Kapaku i kartës së memories

16 Foleja e kartës së memories

* Për hollësi mbi aksesoret e mbështetur nga kapësja MIS, vizitoni faqen e Sony-t për vendin ku ndodhëni ose konsultohuni me shitësin e Sony-t ose pikën e autorizuar lokale të shërbimit të Sony-t.


Për kapësen e aksesoreve mund të përdoren dhe aksesorë.

Funksionimi nuk garantohej me aksesorë të prodhuesve të tjerë.

ni Multi
Interface Shoe

Accessory Shoe

Pamja e poshtme




- 1 Foleja e futjes së baterisë (25)
- 2 Kapaku i baterisë (25)
- 3 Vrima e folesë së trekëmbëshit

- Përdorni trekëmbësh me vidë nën 5,5 mm (7/32 inç). Përndryshe, nuk do të mund ta siguron kamerën dhe mund ta dëmtoni.


Kapaku i pllakës së lidhjes

Përdorni këtë kur përdorni ushqyes AC-PW20 (shitet veçmas). Futeni pllakën e lidhjes në folenë e baterisë dhe kalojeni kordonin përgjatë kapakut të pllakës së lidhjes siç tregohet më poshtë.



- Sigurohuni që kordoni të mos kapet kur mbyllni kapakun.

Objektivi FE 28-70 mm F3.5-5.6 OSS (vjen me ILCE-7K)




- 1** Unaza e fokusimit
- 2** Unaza e zmadhimit
- 3** Rrezja e fokusimit
- 4** Treguesi i rrezes së fokusimit
- 5** Kontaktet e objektivit*
- 6** Piketat e montimit

* Mos e prekni drejtpërdrejt këtë pjesë.


Listë e ikonave në ekran

Statusi i ekranit LCD caktohet në [Display All Info.] në cilësimet fillestare. Kur ndryshoni cilësimin [DISP button] dhe pastaj nëse shtypni DISP në rotullën e komandimit, statusi i ekranit do të ndryshojë në modalitet „For viewfinder“. Mund gjithashtu të shfaqni histogramën duke shtypur DISP.

Për modalitetin e ekranit LCD




Për laujtje (shfaqja e informacionit bazë)











Për modalitetin e pamjekërkuesit

Në modalitet Modaliteti automatik ose Zgjedhja e skenës




Modaliteti P/A/S/M/Panoramë e plotë




Ekрани	Treguesi
REC 0:12	Koha e filmimit (m:s)
	Fokusi
1/250	Shpejtësia e diafragmës
F3.5	Vlera e aperturës
ISO400 ISO AUTO	Ndjeshmëria ISO
*	Kyçja e AE-së
	Treguesi i shpejtësisë së diafragmës
	Treguesi i aperturës
	Histograma
HDR 	Paralajmërimi i figurës automatike HDR
 	Gabim i efektit të figurës
2013-1-1 10:37	Data e regjistrimit
3/7	Numri i skedarit/ Numri i skedarëve në modalitetin e pamjes

Përdorimi i kamerës


Si të përdoret rrotulla e komandimit



- Mund të lëvizni rrotullën e komandimit ose të shtypni lart/poshtë/majtas/djathtas në rrotull për të lëvizur kuadrin e zgjedhur. Shtypni ● në mes të rrotullës së komandimit për të caktuar artikullin e zgjedhur. Në këtë manual, veprimi i shtypjes së anës lart/poshtë/majtas/djathtas së rrotullës së komandimit tregohet nga ▲/▼/◀/▶.
- Funkzionet e mëposhtme i caktohen ▲/◀/▶ në rrotullën e komandimit. Ndjeshmërinë ISO mund ta ndryshoni dhe menjëherë duke lëvizur rrotullën e komandimit.

▲	DISP	Ndryshon pamjen në ekran.
▶	WB	Balanca e të bardhës
◀		Modaliteti i lëvizjes <ul style="list-style-type: none">• Shkrepja e vazhdueshme/Mbajtësja• Kohëmatësi automatik

- Mund të caktoni funksione sipas dëshirës për butonat ▼/◀/▶/● dhe sipas pozicionit të lëvizjes së rrotullës së komandimit në modalitetin e shkrepjes.
- Kur lëvizni rrotullën e komandimit ose shtypni ◀/▶ në rrotull gjatë modalitetit të luajtjes, mund të shfaqni foton e mëparshme ose të mëpasme.

Si të përdoret graduesi i përparmë/pasmë

Graduesin e përparmë ose të pasmë mund ta rrotulloni për të ndryshuar cilësimet e kërkuara për çdo modalitet shkrepjeje me veprim të menjëhershëm.

Zgjedhja e një funksioni me anë të butonit Fn (funksioni)

Ky buton përdoret për të konfiguruar ose ekzekutuar funksionet e përdorura më shpesh gjatë shkrepjes, përveç funksioneve nga ekrani Shfletimi i shpejtë.

1 Shtypni DISP në rrotullën e komandimit për të caktuar modalitetin aktual të ekranit në diçka të ndryshme nga [For viewfinder].

2 Shtypni butonin Fn.




3 Zgjidhni artikullin e dëshiruar me anë të ▲/▼/◀/▶ në rrotullën e komandimit.

Shfaqet ekrani i konfigurimit.

4 Zgjidhni cilësimin e dëshiruar duke rrotulluar graduesin e përparmë, pastaj shtypni ● në rrotullën e komandimit.

- Disa vlera të cilësimeve mund të rregullohen më hollësisht duke rrotulluar graduesin e pasmë.



Për të caktuar cilësimet individuale në ekranin e posaçëm

Në hapin 3, zgjidhni një artikull konfigurimi dhe shtypni ● në rrotullën e komandimit për të kaluar në ekranin e posaçëm për konfigurimin e artikullit. Caktoni artikujt sipas udhëzuesit të veprimeve.



Udhëzuesi i veprimeve


Funksionet që mund të zgjidhen me anë të butonit MENU

Mund të konfiguroni cilësimet bazë për kamerën në tërësi ose të ekzekutoni funksione si p.sh. shkrepja, luajtja ose veprimet të tjera.

1 Shtypni butonin MENU për të shfaqur ekranin e menysë.

2 Zgjidhni artikullin e dëshiruar për konfigurim me anë të ▲/▼/◀/▶ në rrotullën e komandimit ose duke e lëvizur rrotullën e komandimit, dhe pastaj shtypni ● në mes të rrotullës së komandimit.


- Zgjidhni një ikonë në krye të ekranit dhe shtypni ◀/▶ në rrotullën e komandimit për të lëvizur drejt një artikulli tjetër MENU.



3 Zgjidhni vlerën e konfigurimit, pastaj shtypni ● për ta konfirmuar.

Për të shfaqur Menynë me kuadrate


Mundëson zgjedhjen nëse duhet shfaqur gjithnjë ekrani i parë i menysë kur shtypni butonin MENU.

MENU →  (Konfigurimi) 2 → [Tile Menu] → [On]

Udhëzuesi i përdorimit brenda kamerës

Mund të përdorni [Custom Key Settings] për t'i caktuar udhëzuesin brenda kamerës butonit të dëshiruar.

Udhëzuesi brenda kamerës shfaq shpjegimet për funksionin apo cilësimin e zgjedhur të menysë.

1 Zgjidhni butonin MENU →  (Cilësimet e personalizuar) 6 → [Custom Key Settings] → funksione të dëshiruara caktuar butonit → [In-Camera Guide].

Shtypni butonin MENU dhe përdorni rrotullën e komandimit për të zgjedhur një artikull në MENU shpjegimin e të cilit dëshironi të lexoni dhe pastaj shtypni butonin [In-Camera Guide] të cilit i është caktuar.

Ngarkimi i paketës së baterisë

Kur përdorni kamerën për herë të parë, sigurohuni të ngarkoni paketën e baterisë NP-FW50 (jepet).


Paketa e baterisë „InfoLITHIUM“ mund të ngarkohet edhe nëse nuk është shkarkuar deri në fund.

Mund të përdoret edhe nëse nuk është ngarkuar deri në fund.


Paketa e baterisë shkarkohet pak nga pak edhe kur nuk e përdorni.

Për të evituar pamundësinë për të shkrepur foto për shkak të baterive, ndërrojeni sërish paketën e baterisë përpara shkrepjes.

- 1 Caktoni çelësin ON/OFF (të ndezjes) në OFF.**




- 2 Rrëshqisni levën për të hapur kapakun.**



- 3 Futeni tërësisht paketën e baterisë, duke përdorur majën e baterisë për të shtypur levën e kyçjes.**

Leva e kyçjes




4 Mbyllni kapakun.



5 Lidhni kamerën me ushqyesin (jepet) me anë të kablos Micro USB (jepet) dhe lidhni ushqyesin në prizë.


Për klientët në SHBA dhe në Kanada



Për klientët në shtete/rajone të tjera ndryshe nga SHBA-ja dhe Kanadaja

Llamba e ngarkimit ndizet në të portokalltë dhe fillon ngarkimi.

- Fikni kamerën gjatë ngarkimit të baterisë.
- Kur llamba e ngarkimit pulson dhe ngarkimi nuk ka mbaruar, hiqeni dhe rivendoseni paketën e baterisë.



Llamba e ngarkimit

Ndezur: Në ngarkim

Fikur: Ngarkimi ka përfunduar

Pulsuese:

Gabim ngarkimi ose ngarkimi është ndërprerë për momentin pasi kamera nuk është në temperaturë të përshtatshme

Shënime

- Nëse llamba e ngarkimit në kamerë pulson kur ushqyesi futet në prizë, kjo tregon se ngarkimi ka ndaluar për momentin pasi temperatura është jashtë diapazonit të rekomanduar. Ngarkimi rifillon kur temperatura të kthehet brenda diapazonit të përshtatshëm. Rekomandojmë ngarkimin e paketës së baterisë në temperaturë ambiente midis 10°C deri në 30°C (50°F deri në 86°F).
- Futeni ushqyesin (jepet) në prizën më të afërt. Nëse ndodhin probleme gjatë përdorimit të ushqyesit, shkëputeni menjëherë nga priza për ta hequr nga burimi i energjisë.
- Kur kamera përdoret për herë të parë ose nëse blini paketë baterie që nuk është përdorur për kohë të gjatë, llamba e ngarkimit mund të pulsojë me shpejtësi kur bateria ngarkohet për herë të parë. Nëse ndodh diçka e tillë hiqeni paketën e baterisë nga kamera dhe rifuteni për ta ringarkuar.
- Mos e ngarkoni baterinë në mënyrë të vazhdueshme apo të përsëritur, pa e përdorur më parë pas një ngarkimi të plotë apo thujse të plotë. Përndryshe mund të degradoni rendimentin e baterisë.
- Hiqeni ushqyesin nga priza pasi të mbarojë ngarkimi.
- Sigurohuni të përdorni vetëm paketa baterish, kablllo Micro USB (jepet) dhe ushqyes (jepet) autentikë të markës Sony.

Koha ngarkimit (ngarkim i plotë)


Koha e ngarkimit është afro 310 min. me ushqyes (jepet).

Shënime

- Koha e mësipërme e ngarkimit vlen për ngarkim pakete baterie të shkarkuar plotësisht në temperaturë 25°C (77°F). Ngarkimi mund të marrë më shumë në varësi të kushteve të përdorimit apo të rrethanave të caktuara.

Ngarkimi me lidhje me kompjuterin

Paketa e baterisë mund të ngarkohet duke lidhur kamerën në kompjuter me anë kabloje Micro USB.



Shënime

- Kini parasysh pikat e mëposhtme kur ngarkoni nga kompjuteri:
 - Nëse kamera lidhet me laptop që nuk është në prizë, do të bjerë niveli i baterisë së laptopit. Mos e ngarkoni për periudhë të gjatë kohe.
 - Mos e ndizni/fikni kompjuterin, as mos e nxirrni kompjuterin nga gjendja e fjetjes nëse ka lidhje USB midis kompjuterit dhe kamerës. Kamera mund të shkaktojë defekt. Shkëputni kamerën nga kompjuteri përpara se ta fikni, ndizni, rindizni ose nxirrni kompjuterin nga fjetja.
 - Nuk jepet asnjë garanci për ngarkimin me kompjuterë të krijuar vetë ose të modifikuar.

Kontrolli i ngarkesës së mbetur në bateri


Në ekran shfaqet treguesi i ngarkesës së mbetur.



Shënime

- Treguesi i shfaqur i ngarkesës së mbetur mund të mos jetë i saktë në rrethana të caktuara.

Për ta hequr paketën e baterisë




Fikni kamerën. Rrëshqisni levën e kyçjes pas konfirmimit se llamba e leximit (faqe 10) është fikur dhe hiqni paketën e baterisë.

Sigurohuni të mos e hidhni përtokë paketën e baterisë.


Futja e kartës së memories (shitet veçmas)

1 Rrëshqisni levën për të hapur kapakun.




2 Fusni kartën e memories (shitet veçmas).

- Me këndin e prerë sipas drejtimit në figurë, futeni kartën e memories derisa të ngecë në vend.



Sigurohuni që këndi i prerë të jetë në drejtimin e duhur.

3 Mbyllni kapakun.



Për ta hequr kartën e memories

Sigurohuni që llamba e leximit (faqe 10) nuk është e ndezur dhe shtyjeni një herë kartën e memories.

Kartat e memories që mund të përdoren

Mund të përdorni kartat e mëposhtme të memories me këtë kamerë. Por, puna konkrete nuk mund të garantohet për të gjitha llojet e kartave të memories.

	Karta e memories	Për foto statike	Për filma
A	Memory Stick PRO Duo	✓	✓ (vetëm Mark2)
	Memory Stick PRO-HG Duo	✓	✓
	Memory Stick XC-HG Duo	✓	✓
B	Kartë memorieje SD	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje SDHC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje SDXC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)

- Në këtë udhëzues produktet në tabelë përmenden të gjitha bashkë si më poshtë:

A: Njësi „Memory Stick PRO Duo“

B: Kartë SD

Shënime

- Fotot e regjistruara në kartë memorieje Njësi „Memory Stick XC-HG Duo“ ose SDXC nuk mund të importohen apo të luhen me kompjuterë ose pajisje AV që nuk mbështesin exFAT*. Sigurohuni që pajisja të mbështesë exFAT përpara se ta lidhni me kamerën. Nëse e lidhni kamerën me pajisje të pambështetur, mund t’ju kërkohej ta formatoni kartën.

Mos e formatoni kurrë kartën pas kësaj kërkese, pasi përndryshe do të fshini të gjitha të dhënat në kartë.


- * exFAT është sistemi i skedarëve që përdoret në kartat e memories Njësi „Memory Stick XC-HG Duo“ dhe SDXC.

Vendosja e objektivit

Caktoni çelësin e ndezjes së kamerës në OFF përpara se të vendosni apo të hiqni objektivin.


1 Hiqni kapakun e trupit nga kamera dhe kapakun e pasmë të objektivit nga mbrapa objektivit.

- Kur ndërroni objektivin, ndërrojeni larg vendeve me pluhur për të evituar hyrjen e pluhurit apo të papastërtive në kamerë.
- Kur shkrepni, hiqeni kapakun e përparmë të objektivit nga përpara objektivit.




2 Vendoseni objektivin duke drejtvijuar shenjat e bardha treguese (treguesit e montimit) midis objektivit dhe kamerës.

- Mbajeni kamerën me objektivin për poshtë për të evituar hyrjen e pluhurit në kamerë.



3 Kur e shtyni objektivin lehtë drejt kamerës, rrotullojeni objektivin në drejtim orar derisa të puthitet në pozicionin e kyçjes.

- Sigurohuni ta vendosni objektivin drejt.




Shënime

- Kur vendosni objektivin mos e shtypni butonin e shkëputjes së objektivit.
- Mos ushtroni forcë kur vendosni objektivin.
- Kërkoheh përshtatës montimi (shitet veçmas) për të përdorur objektivin A-mount (shitet veçmas). Për të përdorur përshtatës montimi, drejtojeni udhëzuesit të përdorimit që vjen me përshtatësin.
- Për të shkrepur foto në kuadër të plotë, përdorni objektivin të disenjuar për kamerë me kuadër të plotë.
- Kur e mbani kamerën me objektivin të montuar, mbajini mirë dhe kamerën dhe objektivin.
- Mos e mbani nga pjesa e objektivit që del për jashtë për arsye rregullimi të fokusit ose të zmadhimit.

Për të hequr objektivin.


- 1** Shtypni deri në fund butonin e shkëputjes së objektivit dhe rrotullojeni objektivin në drejtim kundërorar derisa të ndalojë.



Butoni i shkëputjes së objektivit

- 2** Vendosni kapakët përpara dhe pas objektivit dhe kapakun e trupit në kamerë.

- Përpara se t'i vendosni, pastrojuni pluhurin.



Shënime mbi ndërrimin e objektivit

Me ndërrimin e objektivit, nëse brenda kamerës hyjnë pluhura apo papastërti dhe ngjiten pas sensorit të figurës (pjesa që shndërron dritën në sinjal elektrik), në fotografi mund të shfaqen pika të zeza, në varësi të ambientit të shkrepjes.

Kamera është e pajisur me funksion kundër pluhurit për të evituar rënien e pluhurit mbi sensorin e figurës. Por, kur vendosni/hiqni objektivin sigurohuni gjithnjë ta ndërroni larg vendeve me pluhur.


Caktimi i datës dhe i orës

Kur ndizni kamerën për herë të parë ose pas nisjes së funksioneve, shfaqet ekrani për caktimin e datës dhe të orës.


1 Caktoni çelësin e ndezjes në ON për të ndezur kamerën.

Shfaqet ekrani për caktimin e datës dhe të orës.

- Për ta fikur kamerën caktojini çelësin e ndezjes në OFF.



2 Kontrolloni që të zgjidhet [Enter] në ekran, pastaj shtypni ● në rrotullën e komandimit.



3 Zgjidhni vendndodhjen e dëshiruar gjeografike dhe shtypni ●.

4 Shtypni ▲/▼ në rrotullën e komandimit ose zgjidhni një opsion konfigurimi duke rrotulluar rrotullën e komandimit, pastaj shtypni ●.

5 Shtypni ▲/▼/◀/▶ ose zgjidhni një cilësim sipas dëshirës duke rrotulluar rrotullën e komandimit, pastaj shtypni ●.

6 Përsëritni hapat 4 dhe 5 për të caktuar opsionet e tjera dhe zgjidhni [Enter] e shtypni ● në rrotullën e komandimit.


Për të anuluar veprimin me caktimin e datës dhe të orës.

Shtypni butonin MENU.

Ricaktimi i datës/orës dhe zonës

Ekrani i konfigurimit të datës dhe të orës shfaqet automatikisht kur ndizet korrenti për herë të parë ose kur shkarkohet bateria e brendshme e ringarkueshme rezervë. Për të ricaktuar datën dhe orën, përdorni menyën.

Butoni MENU →  (Konfigurimi) 4 →
[Date/Time Setup] ose **[Area Setting]**



Butoni MENU

Ruajtja e konfigurimit të datës dhe të orës


Kjo kamerë ka bateri të brendshme të ringarkueshme për ruajtjen e datës, orës dhe cilësimeve të tjera pavarësisht nëse kamera ka, ose jo, korrent ose bateri.

Shkrepja e fotove statike

Në modalitetin automatik, kamera analizon subjektin dhe mundëson shkrepjen me cilësimet e duhura.

1 Caktoni çelësin e ndezjes në ON për të ndezur kamerën.

2 Caktoni graduesin e modalitetit në **AUTO** (Modaliteti automatik).



3 Shikoni në pamjekërkues dhe mbani kamerën.

4 Përcaktoni madhësinë e subjektit.


Kur përdorni objektivin me levë zmadhimi:

Lëvizni levën e zmadhimit.

Kur përdorni objektivin me unazë zmadhimi:

Rrotulloni unazën e zmadhimit.

- Zmadhimi optik nuk ofrohet kur ka të montuar objektiv me fokus gjatësie të pandryshueshme.
- Nëse rrezja e zmadhimit të zmadhuesit optik tejkalohet me montimin e një objektivi të zmadhimit të lartë, kamera kalon automatikisht në zmadhim nga ana e kamerës.



5 Për të fokusuar shtypni butonin e diafragmës deri në gjysmë.

- Kur fotoja është në fokus, bie një tingull dhe ● ose ndriçon treguesi (⊙).

6 Për të shkrepur foton shtypni butonin e diafragmës deri në fund.


- Nëse [Auto Obj. Framing] është caktuar në [Auto] gjatë shkrepjes së portreteve, subjekteve nga afër (makro) ose subjekteve të gjurmuara nga [Lock-on AF], kamera analizon skenën dhe shkurton automatikisht foton e shkrepur në një kompozim të përshtatshëm. Do të ruhen të dyja fotot, origjinalja dhe e shkurtuara.



Filmimi

1 Shtypni butonin MOVIE për të nisur filmimin.

- Duke qenë se [MOVIE Button] është caktuar në [Always] në konfigurimin fillestar, filmimi mund të nisë nga cilido modalitet shkrepeje.



Butoni MOVIE


2 Shtypni butonin MOVIE sërish për të ndaluar filmimin.

Shënime

- Tingulli i kamerës gjatë punës mund të regjistrohet gjatë filmimit. Mund ta çaktivizoni regjistrimin e zërit duke caktuar [Audio Recording] te [Off].
- Kur përdorni objektiv me zmadhim të lartë për të evituar filmimin e tingullit të punës së unazës të zmadhimit, rekomandojmë të filmoni duke përdorur levën e zmadhimit. Kur lëvizni levën e zmadhimit, vendoseni gishtin lehtë mbi levë dhe vëreni në punë pa dridhje.
- Koha e vazhdueshme e filmimit varet nga temperatura e ambientit ose gjendja e kamerës. Shihni „Shënime mbi filmimin e vazhdueshëm“ (faqe 57).
- Kur shfaqet ikona [I], temperatura e kamerës është shumë e lartë. Fikeni kamerën dhe prisni derisa temperatura e saj të bjerë.
- Kur regjistroni vazhdimisht për kohë të gjatë, mund t'ju duket sikur kamera është e ngrohtë. Kjo është normale. Gjithashtu mund të shfaqet dhe „Internal temp. high. Allow it to cool.“. Në raste të tilla, fikeni kamerën dhe prisni derisa të jetë sërish gati për shkrepeje.



Luajtja e fotove










1 Shtypni butonin .



Butoni .

2 Zgjidhni një foto duke shtypur në rrotullën e komandimit.

- Për të luajtur filma shtypni  në rrotullën e komandimit.
- Nëse shtypni  në rrotullën e komandimit gjatë luajtjes së një filmi, do të shfaqet paneli i kontrollit.


Paneli i kontrollit	Veprimi gjatë luajtjes së filmave
	Luajtje
	Pushim
	Shpejt përpara
	Shpejt mbrapa
	Luajtje e ngadaltë përpara
	Luajtje e ngadaltë mbrapa
	Filmi në vijim
	Filmi i mëparshëm
	Një kuadër përpara
	Një kuadër
	Cilësimet e volumnit
	Mbyllje e panelit të kontrollit


Shënime

- Filmat e regjistruar me pajisje të tjera mund të mos luhen në këtë kamerë.

Fshirja e fotove


Pas fshirjes së fotos, nuk mund të rikuperohet. Sigurohuni që dëshironi vërtet ta fshini foton përpara se të vijoni më tej.

- 1 Gjatë shfaqjes së fotos që do të fshini, shtypni butonin  (fshirje).**



Butoni  (fshirje)

- 2 Zgjidhni [Delete] me ▲/▼ në rotullën e komandimit dhe shtypni ●.**


- Për të fshirë disa foto njëkohësh, zgjidhni butonin MENU →  (Luajtja) 1 → [Delete].

Shënime




- Fotot e mbrojtura nuk mund të fshihen.

Zgjedhja e modalitetit të shkrepjes

Rrotulloni graduesin e modaliteteve dhe caktoni modalitetin e dëshiruar të shkrepjes.



Disponohen modalitetet e mëposhtme të shkrepjes.

AUTO (Modaliteti automatik)	Mundëson shkrepjen e fotove statike me cilësimet e rregulluara automatikisht.
P (Programi Auto)	Mundëson shkrepjen me ekspozim (shpejtësia e diafragmës dhe vlera e aperturës) të rregulluar automatikisht. Cilësimet e tjera mund të rregullohen manualisht.
A (Përparësia e aperturës)	Shkrep duke rregulluar aperturën dhe duke ndryshuar rrezen e fokusimit, ose duke shfokusuar sfondin.
S (Përparësia e diafragmës)	Rregullon shpejtësinë e diafragmës për të treguar lëvizjen e subjektit.
M (Ekspozimi manual)	Mundëson shkrepjen pas rregullimit manual të ekspozimit (shpejtësia e diafragmës dhe vlera e aperturës) me anë të graduesit të përparmë ose të pasmë.
1/2 (Rithirrja e memories)	Thërret cilësimet e pararegjistruara te [Memory] në  (Cilësimet e kamerës).
SCN (Zgjedhja e skenës)	Mundëson shkrepjen me cilësime të paracaktuara sipas skenës.
 (Panoramë e plotë)	Mundëson shkrepjen e fotove panoramike duke kombinuar disa skedarë.
 (Film)	Mundëson ndryshimin e cilësimeve të shkrepjes dhe filmimin.

Përdorimi i funksioneve Wi-Fi dhe NFC one-touch.

Mund të kryeni veprimet e mëposhtme me anë të funksioneve Wi-Fi dhe NFC One-touch.

Ruajtje të fotove në kompjuter.



Përdorim të celularit si telekomandë për kamerën.



Transferim të fotove nga kamera drejt një celulari.




Shfaqje të fotove statike në televizor.




Për hollësi mbi funksionet Wi-Fi dhe NFC One-touch drejtojeni dokumentit bashkëngjitur „Udhëzuesi i lidhjes Wi-Fi/One-touch (NFC)“ ose udhëzuesit të ndihmës (faqe 52).

Lidhja e kamerës me një pikëhyrje me valë.

Lidhni kamerën me një pikëhyrjen tuaj me valë. Përpara se të nisni procedurën, sigurohuni që të keni me vete SSID-në (emrin e pikëhyrjes) dhe fjalëkalimin e pikëhyrjes.

1 MENU →  (Me valë) **2** → [Access Point Set.].

- 2 Përdorni ▲/▼ në rrotullën e komandimit për të zgjedhur pikëhyrjen ku dëshironi të lidheni. Shtypni ● në qendër të rrotullës së komandimit dhe jepni fjalëkalimin nëse shfaqet një ikonë me pikëhyrje me valë, pastaj zgjidhni [OK].**



Shënime

- Nëse nuk mund ta kryeni lidhjen, drejtojeni udhëzimeve të përdorimit ose kontaktoni me administratorin e pikëhyrjes.
- Për të ruajtur fotot në kompjuter, instaloni softuerin e posaçëm si më poshtë në kompjuter.


Kur përdorni Windows: PlayMemories Home

www.sony.net/pm/

Kur përdorni Mac: Wireless Auto Import

<http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>

Shtimi i aplikacioneve në kamerë (shkarkimi i aplikacioneve)

Mund të shtoni funksionet tuaja të dëshiruara në kamerë duke u lidhur me faqen e shkarkimit të aplikacioneve  (PlayMemories Camera Apps) nëpërmjet internetit. Për shembull, ofrohen funksionet e mëposhtme:

- Mund të përdorni efekte të ndryshme për shkreptjen e fotove.
- Mund të ngarkoni foto në shërbimet e rrjetit drejtpërdrejt nga kamera.

Shkarkimi i aplikacioneve


1 Hyni në faqen e shkarkimit të aplikacioneve.

<http://www.sony.net/pmca>


2 Ndiqni udhëzimet në ekran dhe hapni një llogari të shërbimit.

- Nëse keni llogari, identifikohuni në faqen e shkarkimit të aplikacionit.


3 Zgjidhni aplikacionin e dëshiruar dhe shkarkojeni në kamerë sipas udhëzimeve në ekran.

- Për ta lidhur kamerën me kompjuter Mac, konfiguroni kamerën si më poshtë.
MENU →  (Konfigurimi) 4 → [USB Connection] → [MTP]

① Drejt një foleje USB në kompjuter



② Kablloja Micro USB (jepet)





③ Multiterminali

Shënime


- Funksioni i shkarkimit të aplikacionit mund të mos disponohet në disa shtete dhe rajone. Për hollësi, drejtojeni faqes së shkarkimit të aplikacionit si më lart.

Si të shkarkojmë aplikacionet drejtpërdrejt me anë të funksionit Wi-Fi të kamerës

Aplikacionet mund t'i shkarkoni me anë të funksionit Wi-Fi pa qenë nevoja të lidheni me kompjuter.

Zgjidhni MENU →  (Aplikacioni) → [Application List] →  (PlayMemories Camera Apps), pastaj ndiqni udhëzime në ekran për të shkarkuar aplikacionet.

Hapni paraprakisht një llogari shërbimi.

Zgjidhni pikëhyrjen MENU →  (Me valë) 2 → [Access Point Set.] → për t'u lidhur → ndryshoni [IP Address Setting] në [Auto] nëse është caktuar në [Manual].

Përdorimi i softuerit

Përdorni aplikacionet e mëposhtme për të përmirësuar përdorimin e fotove të shkrepura me kamerë.

- „Image Data Converter“
- „PlayMemories Home“
- „Remote Camera Control“

Për hollësi mbi instalimin, shikoni faqet 49 në 51.

Mjedisi i rekomanduar kompjuterik (Windows)

Rekomandohen sistemet e mëposhtme kompjuterike kur përdorni softuerin dhe importoni foto nga lidhja USB.

Sistemi operativ (i parainstaluar)	Windows Vista* SP2/Windows 7 SP1/Windows 8
„PlayMemories Home“	Procesori: Intel Pentium III 800 MHz e lart (për luajtje/redaktim të filmave me rezolucion të lartë: Intel Core Duo 1,66 GHz e lart /Intel Core 2 Duo 1,66 GHz e lart, Intel Core 2 Duo 2,26 GHz e lart (AVC HD (FX/FH)), Intel Core 2 Duo 2,40 GHz e lart (AVC HD (PS))) Memoria: 1 GB e lart Njësia e diskut: Hapësira diskut e kërkuar për instalimin - rreth 600 MB Ekрани: Rezolucioni i ekranit - 1024 × 768 pika e lart
„Image Data Converter Ver.4“/ „Remote Camera Control Ver.3“	Procesori/memoria: Pentium 4 e lart/1 GB e lart Ekрани: 1024 × 768 pika e lart

* Starter (Edition) nuk mbështetet.

Mjedisi i rekomanduar kompjuterik (Mac)

Rekomandohen sistemet e mëposhtme kompjuterike kur përdorni softuerin dhe importoni foto nga lidhja USB.

Sistemi operativ (i parainstaluar)	Mac OS X v10.6 – v10.8
„PlayMemories Home“	Procesori: Procesorë Intel (Intel Core Solo/Core Duo/ Core 2 Duo etj.) Njësia e diskut: Hapësira diskut e kërkuar për instalimin - rreth 100 MB Ekрани: Rezolucioni i ekranit - 1024 × 768 pika e lart

„Image Data Converter Ver.4“/ „Remote Camera Control Ver.3“	Procesori: Intel Core Solo/Core Duo/Core 2 Duo e lart Memoria: Rekomandohet 1 GB e lart. Ekрани: 1024 × 768 pika e lart
--	--

Shënime

- Funksionimi nuk mund të garantohet në mjedis që mbështetet mbi përmirësimin e sistemeve kompjuterike të përshtetura më lart ose në mjedise me shumë sisteme operative në nisje.
- Nëse lidhni 2 a më tepër pajisje USB në një kompjuter në të njëjtën kohë, disa pajisje, duke përfshirë kamerën, mund të mos funksionojnë, në varësi të llojit të pajisjeve USB që përdorni.
- Lidhja e kamerës me ndërfaqe USB që mbështet USB e shpejtësisë së lartë (pajtohet me USB 2.0) mundëson transferim me shpejtësi të lartë, pasi kamera mbështet USB e shpejtësisë së lartë (pajtohet me USB 2.0).
- Kur kompjuteri rikuperohet nga modaliteti i pezullimit apo fjetjes, komunikimi midis kamerës dhe kompjuterit mund të mos rikuperohet në të njëjtën kohë.

Përdorimi i „Image Data Converter“

Me „Image Data Converter“, mund të kryeni sa më poshtë:

- Mund të luani dhe të redaktoni fotot e regjistruara në format RAW, me korrigjime të ndryshme, si p.sh. kurba e tonalitetit dhe qartësia.
- Mund të rregulloni foto me balancën e së bardhës, ekspozimin, [Creative Style] etj.
- Mund të ruani në kompjuter fotot e shfaqura dhe të redaktuara. Mund ta ruani foton në format RAW ose në format skedari të përgjithshëm.
- Mund të shfaqni dhe të krahasoni foto RAW dhe JPEG të regjistruara nga kjo kamerë.
- Mund të vlerësoni foto në 5 nota.
- Mund të caktoni etiketa me ngjyra.

Për të përdorur „Image Data Converter“, drejtojuuni Ndhimës.

Shtypni [Start] → [All Programs] → [Image Data Converter] → [Help] → [Image Data Converter Ver.4].

Faqja e mbështetjes „Image Data Converter“ (vetëm anglisht)

<http://www.sony.co.jp/ids-se/>

Instalimi për „Image Data Converter“

1 Shkarkoni softuerin nga URL-ja e mëposhtme dhe instalojeni në kompjuter.

Windows:

<http://www.sony.co.jp/imsoft/Win/>

Mac:

<http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>

Shënime

- Identifikohuni si administrator.

Përdorimi i „PlayMemories Home“

Softueri „PlayMemories Home“ mundëson importimin e fotove statike dhe të filmave për përdorim në kompjuter. Kërkohej „PlayMemories Home“ për importimin e filmave AVCHD në kompjuter.



Importimi i fotove nga kamera



Luajtja e fotove të importuara



Ndarja e fotove në „PlayMemories Online“



Për Windows, ofrohen dhe funksionet e mëposhtme.



Shfaqja e fotove në kalendar




Krijimi i disqeve të filmave



Ngarkimi i fotove në shërbimet e rrjetit

Shënime

- Kërkohet lidhje me internetin për të instaluar „PlayMemories Home“.
- Kërkohet lidhje me internetin për të përdorur „PlayMemories Online“ ose shërbime të tjera rrjeti. „PlayMemories Online“ ose shërbime të tjera rrjeti mund të mos ofrohen në disa shtete ose rajone.
- Drejtojuni adresës si më poshtë për softuer për Mac:
<http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>
- Nëse softueri „PMB (Picture Motion Browser)“, që jepet me modelet e qarkulluara përpara 2011, është instaluar tashmë në kompjuter, do të mbishkruhet nga „PlayMemories Home“ gjatë instalimit. Përdorni „PlayMemories Home“, softuerin vijues të „PMB“.
- Filmat e regjistruar me cilësimin [60p 28M(PS)]/[50p 28M(PS)], [60i 24M(FX)]/[50i 24M(FX)] ose [24p 24M(FX)]/[25p 24M(FX)] në  Record Setting] konvertohen nga „PlayMemories Home“ për të krijuar disk regjistrimi AVCHD. Ky konvertim mund të dojë kohë të gjatë. Gjithashtu, nuk mund të krijoni disk me cilësinë fillestare të figurës. Nëse dëshironi të ruani cilësinë fillestare të figurës, ruajini filmat në Disk Blu-ray.

Instalimi për „PlayMemories Home“

1 Me anë të shfletuesit të internetit në kompjuter, shkoni në adresën e mëposhtme dhe shtypni [Install] → [Run].

www.sony.net/pm/


2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar instalimin.

Përdorimi i „Remote Camera Control“

Lidhni kamerën me kompjuterin. Me „Remote Camera Control“ mund të:

- Konfiguroni kamerën ose të regjistroni foto nga kompjuteri.
- Regjistroni foton drejtpërdrejt në kompjuter.
- Kryeni shkrepe me kohëmatës me interval.

Konfiguroni si më poshtë përpara përdorimit: MENU →

 (Konfigurimi) 4 → [USB Connection] → [PC Remote]

Instalimi i „Remote Camera Control“

1 Me anë të shfletuesit të internetit në kompjuter, shkoni në adresën e mëposhtme.

Windows:

<http://www.sony.co.jp/imsoft/Win/>

Mac:

<http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>

2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të shkarkuar dhe instaluar „Remote Camera Control“.

Shënime

- Kërkohet lidhje me internetin për të instaluar „Remote Camera Control“.

Më tepër rreth kamerës („Udhëzuesi i ndihmës“)



„Udhëzuesi i ndihmës“ është manual në internet. Drejtojuni për udhëzime të hollësishme mbi shumë funksione të kamerës.

1 Hapni faqen e mbështetjes së Sony-t.

<http://www.sony.net/SonyInfo/Support/>


2 Zgjidhni shtetin ose rajonin tuaj.

3 Kërkoni për emrin e modelit të kamerës suaj brenda faqes së mbështetjes.

- Kontrolloni emrin e modelit në fund të kamerës.
-

Kontrolli i numrit të fotove dhe i kohës së filmimit

Kur futni kartë memorieje në kamerë dhe e caktoni çelësin e ndezjes në ON, shfaqet në ekran numri i fotove që mund të regjistrohen (nëse vazhdoni shkrepjen me cilësimet aktuale).



Shënime

- Kur „0“ (numri i fotove të regjistrueshme) pulson në të verdhë, karta e memories është plot. Ndërrojeni kartën e memories me një tjetër ose fshini fotot nga karta aktuale e memories (faqja 41).
- Kur „NO CARD“ (numri i fotove të regjistrueshme) pulson në të verdhë, do të thotë se nuk është futur kartë memorieje. Futni një kartë memorieje.

Numri i fotove që mund të regjistrohen në një kartë memorieje


Tabela më poshtë tregon numrin e përafërt të fotove që mund të regjistrohen në kartë memorieje të formatuar në këtë kamerë. Vlerat janë përcaktuar duke përdorur memorie standarde Sony për testim. Vlerat mund të luhaten në varësi të kushteve të shkrepjes dhe llojit të kartës së përdorur të memories.

ILCE-7:**Madhësia e figurës: L: 24M****Raporti i pamjes: 3:2*****Karta e memories formatuar me këtë kamerë****(Njësi: Foto)**

Madhësia \ Kapaciteti	2 GB	4 GB	8 GB	16 GB	32 GB	64 GB
Standard	280	560	1100	2250	4600	9200
Fine	195	395	800	1600	3200	6400
Extra fine	105	215	435	870	1700	3450
RAW & JPEG	54	105	215	435	870	1750
RAW	74	145	295	600	1200	2400

ILCE-7R:**Madhësia e figurës: L: 36M****Raporti i pamjes: 3:2*****Karta e memories formatuar me këtë kamerë****(Njësi: Foto)**

Madhësia \ Kapaciteti	2 GB	4 GB	8 GB	16 GB	32 GB	64 GB
Standard	215	440	890	1750	3550	7000
Fine	145	295	600	1200	2400	4800
Extra fine	78	150	310	630	1250	2500
RAW & JPEG	37	75	150	300	610	1200
RAW	50	99	200	405	810	1600

* Kur  Aspect Ratio] është caktuar në [16:9], mund të regjistroni më shumë foto se numrat e treguar në tabelën më lart (përveç kur zgjidhet [RAW]).

Numri i fotove që mund të regjistrohen me një paketë baterie

Kini parasysh se numrat aktualë mund të dallojnë në varësi të kushteve të përdorimit.

ILCE-7:

	Jetëgjatësia e baterisë	Numri i fotove
Shkrepja (foto statike)	Afërsisht 135 min.	Afërsisht 270 foto
Shkrepje aktuale (filma)	Afërsisht 60 min.	—
Shkrepje e vazhdueshme (filma)	Afërsisht 100 min.	—
Shfaqja (foto statike)	Afërsisht 280 min.	Afërsisht 5600 foto

ILCE-7R:

	Jetëgjatësia e baterisë	Numri i fotove
Shkrepja (foto statike)	Afërsisht 135 min.	Afërsisht 270 foto
Shkrepje aktuale (filma)	Afërsisht 60 min.	—
Shkrepje e vazhdueshme (filma)	Afërsisht 90 min.	—
Shfaqja (foto statike)	Afërsisht 280 min.	Afërsisht 5600 foto

Shënime

- Numri i mësipërm i fotove vlen kur paketa e baterisë është tërësisht e ngarkuar. Numri i fotove mund të bjerë në varësi të kushteve të përdorimit.
- Numri i fotove që mund të regjistrohen është për shkrepje në kushtet si më poshtë:
 - Paketa e baterisë përdoret në temperaturë ambienti prej 25°C (77°F).
 - Përdorimi i objektivit FE 28-70 mm F3.5-5.6 OSS.
 - Përdorimi i Njësi „Memory Stick PRO Duo“ (Mark2) Sony (shitet veçmas).
 - [Viewfinder Bright.] është caktuar në [Manual] [±0].
 - [Monitor Brightness] është caktuar në [Manual] [±0].
 - [Display Quality] është caktuar në [Standard] (ILCE-7)/[High] (ILCE-7R).
- Numri për „Shkrepje (foto statike)“ mbështetet mbi standardin CIPA dhe është për shkrepje në kushtet si më poshtë:
 - (CIPA: Camera & Imaging Products Association)
 - [Focus Mode] është caktuar në [Single-shot AF].
 - Një shkrepje çdo 30 sekonda.
 - Pajisja ndizet dhe fiket një herë në çdo dhjetë herë.

- Numri i minutave për filmim mbështetet mbi standardin CIPA dhe është për shkrepje në kushtet si më poshtë:
 - [RECORD] Record Setting] është caktuar në [60i 17M(FH)]/[50i 17M(FH)].
 - Shkrepje tipike për filma: Kohëzgjatja e baterisë mbështetet mbi shkrepje, zmadhim, pritje, fikje/ndezje etj.
 - Shkrepje e vazhdueshme për filma: Kohëzgjatja e baterisë për shkrepje pa ndalesa deri në kapjen e cakut (29 minuta) dhe e vazhduar duke rishtypur butonin MOVIE. Funksione të tjera, si zmadhimi, nuk përdoren.

Koha e disponueshme për një film

Tabela më poshtë tregon kohën e përafërt gjithsej të regjistrimit me kartë memorieje të formatuar në këtë kamerë.


Karta e memories formatuar me këtë kamerë

(h (orë), m (minuta))



Kapaciteti Konfigurimi i regjistrimit	2 GB	4 GB	8 GB	16 GB	32 GB	64 GB
60i 24M(FX)/ 50i 24M(FX)	10 m	20 m	40 m	1 h 30 m	3 h	6 h
60i 17M(FH)/ 50i 17M(FH)	10 m	30 m	1 h	2 h	4 h 5 m	8 h 15 m
60p 28M(PS)/ 50p 28M(PS)	9 m	15 m	35 m	1 h 15 m	2 h 30 m	5 h 5 m
24p 24M(FX)/ 25p 24M(FX)	10 m	20 m	40 m	1 h 30 m	3 h	6 h
24p 17M(FH)/ 25p 17M(FH)	10 m	30 m	1 h	2 h	4 h	8 h
1440×1080 12M	20 m	40 m	1 h 20 m	2 h 45 m	5 h 30 m	11 h
VGA 3M	1 h 10 m	2 h 25 m	4 h 55 m	10 h	20 h	40 h

- Shkrepja e vazhdueshme është e mundur për rreth 29 minuta (kufi i specifikimeve të produktit). Koha e filmimit maksimal të vazhdueshëm në format MP4 (12M) është rreth 20 minuta (kufizuar nga kufizimi për madhësi maksimale skedari prej 2 GB).

Shënime

- Koha e regjistrueshme e filmave ndryshon pasi kamera është e pajisur me VBR (shpejtësi të ndryshueshme bitësh), e cila rregullon automatikisht cilësinë e figurës sipas skenës së regjistrimit. Kur regjistroni subjekte në lëvizje të shpejtë, figura është më e qartë, por koha e regjistrimit është më e ulët, pasi kërkohet më tepër memorie për regjistrim.
Koha e regjistrueshme ndryshon dhe në varësi të kushteve të regjistrimit, subjektit, ose cilësimeve të cilësisë/madhësisë së figurës.
- Vlerat e shfaqura nuk janë për kohë të vazhdueshme regjistrimi.
- Koha e regjistrimit mund të ndryshojë në varësi të kushteve të shkrepjes dhe të kartës së memories që përdoret.
- Kur shfaqet , ndaloni filmimin. Temperatura brenda kamerës ka arritur nivel të papranueshëm.
- Për hollësi mbi luajtjen e filmit, shihni faqen 40.

Shënime mbi filmimin e vazhdueshëm

- Ka nevojë për shumë energji për të kryer filmim të cilësisë së lartë ose shkrepje të vazhdueshme nëpërmjet sensorit të figurës. Prandaj nëse vazhdoni shkrepjen, temperatura brenda kamerës do të rritet, sidomos ajo e sensorit të figurës. Në raste të tilla, kamera fiket automatikisht, duke qenë se temperaturat e larta prekin cilësinë e figurës ose ndikojnë në mekanizmin e brendshëm të kamerës.
- Kohëgjatja e disponueshme për filmim ndryshon me temperaturën ose kushtet e kamerës përpara se të nisni regjistrimin. Nëse rikomponzi ose shkrepni shpesh foto pas fikjes së pajisjes, temperatura brenda kamerës do të rritet dhe koha e disponueshme e regjistrimit do të jetë më e shkurtër.
- Nëse kamera ndalon regjistrimin për shkak të temperaturës, lëreni për pak minuta të fikur. Nisni regjistrimin pasi temperatura brenda kamerës të bjerë tërësisht.
- Nëse zbatoni pikat si më poshtë, koha e regjistrimit do të jetë më e gjatë.
 - Mbajeni kamerën larg dritës së drejtpërdrejtë të diellit.
 - Fikeni kamerën kur nuk përdoret.
- Madhësia maksimale e skedarit të filmit është rreth 2 GB. Kur madhësia e skedarit është rreth 2 GB, regjistrimi ndalon automatikisht kur  File Format] është caktuar në [MP4] dhe krijohet automatikisht skedar i ri filmi kur  File Format] është caktuar në [AVCHD].
- Koha maksimale e regjistrimit të vazhdueshëm është 29 minuta.

Specifikimet

Kamera

[Sistemi]

Lloji i kamerës: Kamerë dixhitale me objektiv të ndërrueshëm
Objektivi: Objektivi E-mount

[Sensori i figurës]

Formati i fotos:

ILCE-7: 35mm madhësi e plotë (35,8 mm × 23,9 mm), sensor figure CMOS

ILCE-7R: 35mm madhësi e plotë (35,9 mm × 24,0 mm), sensor figure CMOS

Numri i pikëzave gjithsej të kamerës:

ILCE-7:

Afërsisht 24,7 megapikëza

ILCE-7R:

Afërsisht 36,8 megapikëza

Numri efektiv i pikëzave të kamerës:

ILCE-7:

Afërsisht 24,3 megapikëza

ILCE-7R:

Afërsisht 36,4 megapikëza

[Kundër pluhurit]

Sistemi: Veshje për mbrojtje të ngarkesës në filtrin optik dhe mekanizmin e dridhjeve me ultratinguj

[Sistemi i fokusimit automatik]

Sistemi:

ILCE-7:

Sistem zbulimi të fazës/sistem zbulimi të kontrastit

ILCE-7R:

Sistemi i zbulimit të kontrastit

Rrezja e ndjeshmërisë: 0 EV deri në

20 EV (në ISO 100 barasvlefshëm me objektiv F2,8)

[Pamjekërkuesi elektronik]

Lloji: Pamjekërkuesi elektronik

Numri i pikave gjithsej:

2 359 296 pika

Mbulimi i kuadrit: 100%

Zmadhimi: 0,71 × me objektiv 50 mm në pafundësi, -1 m^{-1} (dioptria)

Pika e shikimit: Afërsisht 27 mm nga okulari, 22 mm nga korniza e okularit në -1 m^{-1}

Rregullimi i dioptrisë: $-4,0 \text{ m}^{-1}$ deri në $+3,0 \text{ m}^{-1}$ (dioptria)

[Ekрани LCD]

Paneli LCD: 7,5 cm (lloji 3.0) me bazë TFT

Numri i pikave gjithsej: 921 600 pika

[Kontrolli i ekspozimit]

Metoda e matjes: Matje vlerësuese 1200-zonëshe nga sensori i figurës

Rrezja e matjes: 0 EV deri në 20 EV (në ISO 100 barasvlefshëm me objektiv F2,8)

Ndjeshmëria ISO (treguesi i rekomanduar i ekspozimit):
Foto statike: [ISO AUTO], ISO 50 deri në 25 600 (hapi 1/3 EV)
Filmat: [ISO AUTO], ISO 200 deri në 25 600 (hapi 1/3 EV)
Reduktimi i zhurmës me shkrepje shumëkuadrëshe: [ISO AUTO]/ ISO 100 deri në 51 200 (hapi 1 EV)
Kompensimi i ekspozimit: $\pm 5,0$ EV (i këmbësor midis hapave 1/3 dhe 1/2 EV)

[Diafragma]

Lloji: E llojit me kontroll elektronik, vijë vertikale, përpara sensorit
Diapazoni i shpejtësisë:
Foto statike: 1/8000 e sekondës deri në 30 sekonda, llamba
Filmat: 1/8000 e sekondës deri në 1/4 e sekondës (hapi 1/3) në pajisje që mbështet 1080 60i deri në 1/60 e sekondës në modalitet AUTO (deri në 1/30 e sekondës në modalitet të ngadaltë automatik të diafragmës)
në pajisje që mbështet 1080 50i deri në 1/50 e sekondës në modalitet AUTO (deri në 1/25 e sekondës në modalitet të ngadaltë automatik të diafragmës)

Shpejtësia e sinkronizimit të blicit:
ILCE-7: 1/250 e sekondës
ILCE-7R: 1/160 e sekondës

[Formati i regjistrimit]



Formati i skedarëve: Mbështet JPEG (DCF Ver. 2.0, Exif Ver. 2.3, MPF Baseline), RAW (format Sony ARW 2.3)
Filmat (format AVCHD): Mbështet format AVCHD Ver. 2.0
Video: MPEG-4 AVC/H.264
Audio: 2-kanalëshe Dolby Digital, pajisur me Dolby Digital Stereo Creator

- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories.
Filmat (format MP4):
Video: MPEG-4 AVC/H.264
Audio: 2-kanalëshe MPEG-4 AAC-LC

[Mjetet e regjistrimit]

Njësi „Memory Stick PRO Duo“, kartë SD

[Foletë hyrëse/dalëse]

Multiterminali*: USB e shpejtësisë së lartë (USB 2.0)
HDMI: Mikrofole HDMI e llojit D
Fole  (mikrofon): Minifole \varnothing 3,5 mm stereo
Fole  (kufjet): Minifole \varnothing 3,5 mm stereo
* Mbështet pajisje me Micro USB.

[Energjia, e përgjithshme]

Paketa e përdorur e baterisë:
 Paketë baterie të ringarkueshme
 NP-FW50

[Konsumi i energjisë]

Kur përdoret FE 28-70 mm F3.5-5.6
 OSS*

ILCE-7:

Kur përdoret pamjekërkuesi:

Afërsisht 3,5 W

Kur përdoret ekrani LCD:

Afërsisht 2,7 W

ILCE-7R:

Kur përdoret pamjekërkuesi:

Afërsisht 3,5 W

Kur përdoret ekrani LCD:

Afërsisht 2,7 W

* Vjen me ILCE-7K

[Të tjera]

Printim për Exif: Mbështetet
 PRINT Image Matching III:

Mbështetet

DPOF: Mbështetet

Përmasat: Afërsisht 126,9 mm ×
 94,4 mm × 48,2 mm (afërsisht
 5 inçë × 3 7/10 inçë × 1 9/10 inçë)
 (GJ/L/TH, pa llogaritur pjesët
 e dala)

Masa:

ILCE-7:

Afërsisht 474 g (1 lb 0,7 oz)
 (me bateri dhe Njësi „Memory
 Stick PRO Duo“)

Afërsisht 416 g (14,7 oz)
 (vetëm trupi)

ILCE-7R:

Afërsisht 465 g (1 lb 0,4 oz)
 (me bateri dhe njësi
 „Memory Stick PRO Duo“)
 Afërsisht 407 g (14,4 oz)
 (vetëm trupi)

Temperatura ku mund të përdoret:
 0°C deri 40°C (32°F deri 104°F)

[LAN me valë]

Formati i mbështetur:

IEEE 802.11 b/g/n

Brezi i frekuencës: Gjerësia e brezit
 2,4 GHz

Mbrojtja: WEP/WPA-PSK/
 WPA2-PSK

Metoda e lidhjes: WPS (konfigurim
 i mbrojtur Wi-Fi)/Manual

Mënyra e hyrjes: Modalitet
 „Infrastructure“

NFC: Pajtohet me NFC Forum
 Type 3 Tag

Ushqyesi AC-UB10C/UB10D

Kërkesat për energji: AC 100 V deri
 240 V, 50 Hz/60 Hz, 70 mA
 Voltazhi në dalje: DC 5 V, 0,5 A
 Temperatura ku mund të përdoret:
 0°C deri në 40°C
 (32°F deri në 104°F)

Temperatura e ruajtjes: -20°C deri në
 +60°C (-4°F deri në +140°F)

Përmasat (afërsisht):

50 mm × 22 mm × 54 mm
 (2 inçë × 7/8 inçë ×
 2 1/4 inçë) (GJ/L/TH)

Paketë baterie të ringarkueshme NP-FW50

Bateria e përdorur: Bateri me jone litiumi

Voltazhi maksimal: DC 8,4 V

Voltazhi nominal: DC 7,2 V

Voltazhi maksimal i ngarkesës:
DC 8,4 V

Rryma maksimale e ngarkesës: 1,02 A

Kapaciteti: Tipik 7,7 Wh (1 080 mAh)
Minimal: 7,3 Wh (1 020 mAh)

Përmasat maksimale:

Afërisht 31,8 mm × 18,5 mm ×
45 mm (1 5/16 inçë × 3/4 inçë ×
1 13/16 inçë) (GJ/L/TH)

Objektivi FE 28-70 mm F3.5-5.6 OSS (pajisur me ILCE-7K)

Gjatësia e fokusimit: 28 mm – 70 mm

Grupet-elementë të objektivit: 8–9

Këndi i pamjes: 75° – 34°

Fokusi minimal*: 0,3 m – 0,45 m
(0,99 ft. – 1,48 ft.)

Zmadhimi maksimal: 0,19×

Ndalimi minimal i fokusit: f/22 – f/36

Diametri i filtrit: 55 mm

Përmasat (diametri maksimal ×
lartësia):

Afërsisht 72,5 mm × 83 mm
(afërsisht 2 7/8 inçë × 3 3/8 inçë)

Masa: Afërsisht 295 g
(afërsisht 10,5 oz)

SteadyShot: Nuk disponohet

*Fokusi minimal është distanca më e shkurtër nga sensori i figurës deri te subjekti.

Disenjimi dhe specifikimet mund të ndryshohen pa njoftim paraprak.

Mbi mbështetjen për të dhënat e fotove

- Kjo kamerë pajtohet me DCF (rregullin e disenjimit për sistemin e skedarëve për kamera) me standardin universal të përcaktuar nga JEITA (Japan Electronics and Information Technology Industries Association).
- Luajtja në pajisje të tjera e fotove të regjistruara me kamerën tënde dhe luajtja në kamerën tënde e fotove të regjistruara ose të redaktuara me pajisje të tjera nuk garantohehen.

Markat tregtare

- Markat e mëposhtme janë marka tregtare të Sony Corporation.
α, „Memory Stick“, „Memory Stick PRO“, **MEMORY STICK PRO**, „Memory Stick Duo“, **MEMORY STICK DUO** „Memory Stick PRO Duo“, **MEMORY STICK PRO DUO** „Memory Stick PRO-HG Duo“, **MEMORY STICK PRO-HG DUO** „Memory Stick XC-HG Duo“, **MEMORY STICK XC-HG DUO** „MagicGate“, **MAGIC GATE**, „BRAVIA“, „InfoLITHIUM“, „PlayMemories Camera Apps“, „PlayMemories Home“, „PlayMemories Online“, „PlayMemories Mobile“.
- „AVCHD Progressive“ dhe logotipi „AVCHD Progressive“ janë marka tregtare të Panasonic Corporation dhe të Sony Corporation.
- Dolby dhe simboli me dy „D“ janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- Microsoft, Windows dhe Windows Vista janë marka të regjistruara tregtare të Microsoft Corporation në SHBA dhe/ose në shtete të tjera.
- Termat HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing LLC në SHBA dhe në shtete të tjera.
- Mac, Mac OS janë marka të regjistruara tregtare të Apple Inc.
- iOS është markë e regjistruar tregtare ose markë tregtare e Cisco Systems, Inc. dhe/ose e filialeve të saj në SHBA dhe në shtete të tjera të caktuara.
- iPhone dhe iPad janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruara në SHBA dhe në shtete të tjera.
- Intel, Intel Core, dhe Pentium janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Intel Corporation.
- Logoja SDXC është markë tregtare e SD-3C, LLC.
- Android, Google Play janë marka tregtare të Google Inc.
- Wi-Fi, logoja Wi-Fi, Wi-Fi PROTECTED SET-UP janë marka të regjistruara tregtare të Wi-Fi Alliance.
- Shenja N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në SHBA dhe në shtete të tjera.
- DLNA dhe DLNA CERTIFIED janë marka tregtare të Digital Living Network Alliance.
- „PS“ dhe „PlayStation“ janë marka të regjistruara tregtare të Sony Computer Entertainment Inc.
- Facebook dhe logoja „f“ janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Facebook, Inc.
- YouTube dhe logoja YouTube janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Google Inc.
- Eye-Fi është markë tregtare e Eye-Fi, Inc.

- Gjithashtu, emrat e sistemeve dhe të produkteve të përdorura në këtë udhëzues janë, në përgjithësi, marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të zhvilluesve ose prodhuesve përkatës. Por, shenjat TM or [®] nuk përdoren në të gjitha rastet në këtë udhëzues.



- Shtoni argëtimin me PlayStation 3 tuaj duke shkarkuar aplikacionin për PlayStation 3 nga PlayStation Store (aty ku disponohet).
- Aplikacioni për PlayStation 3 kërkon llogari Playstation Network dhe shkarkim të aplikacionit. Mund të hapet në zona ku ka PlayStation Store.





<http://www.sony.net/SonyInfo/Support/>

Informacione të tjera mbi këtë produkt dhe
përgjigje ndaj pyetjeve të shpeshta mund
të gjenden në faqen tonë të shërbimit të klientit
në internet.

<http://www.sony.net/>

©2013 Sony Corporation